



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 156, datë 23.12.2014

**PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 12, DATË 30.01.2013,
“PËR HARTIMIN, NDJEKJEN, MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT PËR
AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 128 të Kodit të Procedurës Administrative, me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 12, datë 30.01.2013, “Për hartimin, ndjekjen, miratimin dhe zbatimin e buxhetit për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI

Në Rregulloren nr. 12, datë 30.01.2013, “Për hartimin, ndjekjen, miratimin dhe zbatimin e buxhetit për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 3, Përkufizime, pas pikës n) shtohet pika nj) me këtë përmbajtje: *“fond rezervë” ka të njëjtin përcaktim me nenin 26, pika c), të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar.*
2. Në nenin 19, në paragrafin 4, pas fjalës “klasat” shtohet fjala “kategoritë”.
3. Në shtojcën nr. 1 “Lista me elementët përbërës” shtohet Kategoria III “Fondi Rezervë”.
4. Në shtojcën nr. 2 “Raportimi dhe përpunimi i treguesve për buxhetin” shtohet treguesi III “Fondi Rezervë” planifikimi dhe përdorimi i tij nga njësia e buxhetimit, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme.
5. Pas shtojcës nr. 4, shtohet Shtojca nr. 5 “Fondi rezervë dhe përdorimi i tepricës” si më poshtë:

Shtojca 5

Fondi rezervë dhe përdorimi tepricës

	TREGUESIT	Plan	Fakt	Ndryshimi
1	Të Ardhura			
2	Shpenzime funksionimi			
3	Diferenca (1-2) Nëse >0			
4	Fondi rezervë për t`u krijuar 4.1 Buxheti vitit t-3 4.2 Buxheti vitit t-2 4.3 Buxheti vitit t-1 4.4 Buxheti mesatar 6 mujor 4.1+4.2.+4.3 (-----) : 2 3			
5	Fondi rezervë t-1			
6	Ndryshimi në fondin rezervë (4-5)			
7	Diferenca 3-6 Nëse > 0			
8	Paradhënie e subjekteve të mbikëqyrura për vitin pasardhës			